



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:294331  
Datë: 09.02.2024  
Numri i dokumentit: 05306323

**C.nr.2053/23**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Xh. S., Xh. Ç., Z. Xh. dhe H. P., të cilët i përfaqëson Av.Uvejs Gashi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, Baza juridike: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seancës me dt.09.02.2024 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET MARRVESHJA JASHTËGJYQËSORE**, me numër të lëndës Nd.nr.... , e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Mitrovicë me datë ..., në mes të paditësve paditësve Xh. S., Xh. Ç., Z. Xh. dhe H. P., të cilët i përfaqëson Av.Uvejs Gashi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, Baza juridike: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit, dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbares.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore Mitrovicë, me datë ..., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike: Kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit.

Qendra për Ndërmjetësimin, e ka njoftuar gjykatën me dt. ..., se palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 412 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 14 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me dt.28.07.2018, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbares, pra paraqet titullit përmbares.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2053/23 me dt.09.02.2024**

**Gj y q t a r i**  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.